



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



# Buletini Javor I

17 Nëntor 2014

## Pak fjalë për projektin:

Projekti “Ngritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin gjyqësor” është një projekt i financuar nga ATRC dhe USAID. Ky projekt ka për qëllim që të përmirësoj çasjen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në sistemin gjyqësor përmes shpërndarjes së informacioneve të nevojshme dhe duke rritur ndërgjegjësimin në nivelin e komunitetit. Gjithashtu organizata INPO përmes projektit tenton të përmirësoj mbikqyrjen e kujdesshme të gjykatave dhe të promovoj transparencën dhe llogaridhënien e sistemit gjyqësor kundrejt publiku.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit është monitorimi i afërt i Gjykatës Themelore të

Ferizajt dhe degëve të saj në Kaçanik dhe Shtëprcë. Ky monitorim ka për qëllim të nxirren të dhëna sa i përket pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset gjyqësore, pastaj monitorimin se sa Gjykata jep informacione të nevojshme dhe në kohë sa i përket proceseve gjyqësore (koha, vendi).

Gjithashtu, pas monitorimi pjesë e projektit është edhe publikimi i një buletini javor, ku do të publikohen të dhënat e marra nga monitoruesit e organizatës gjatë monitorimit të afërt të gjykatës. Përmes këtyre informatave tentohet të informohet publiku se sa Gjykatat janë të hapura dhe se sa janë qytetarët të interesuar të përcjellin procese gjyqësore.

## Të dhëna të monitorimit:

Gjatë javës së parë të nëntorit janë monitoruar Gjykata Themelore në Ferizaj dhe Degët në Kaçanik dhe Shtëprcë. Në vazhden e monitorimit, monitoruesit kanë vërejtur disa shqetësime.

Së pari, të gjitha seancat të monitoruara janë mbajtur në zyrën e Gjykatës të procedurës. Në seancën e zhvilluar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, me datë

06.11.2014, edhe pse salla e gjykimeve ishte e lirë, ajo është mbajtur në zyrën e Gjykatës. Zyret e Gjykatësve janë hapësira të vogla, ku mundësia që qytetarët të marrin pjesë në përcjelljen e seancave është shumë e vogël.

Së dyti, në të trija seancat e monitoruara, pjesëmarrës kanë qenë vetëm palët në procedurë.

©Iniciativa Për Progres, Projekti “Ngritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin gjyqësor”

**"Ky buletin u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e INPO-s dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara"**